

Për Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga z. Sokol Haliti - Kryetar i Komunës/ Viti

Datë 17.06.2021



**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**

Të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale për vitin fiskal 2019

Nr	Gjetja/titulli	Rekomandimi	zyrja e priojekteve pranë zyrës së kryetarit-zyrtari i caktuar si menagjer i projektit	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Koha/Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	E gjetura 1 - Të vendosin proces të dokumentuar të prioritizimit të projekteve në të cilat do të investohet. Komunat duhet që të përcaktojnë kriteret për prioritizimin e projekteve duke u bazuar në rëndësinë strategjike, vlerësimin ekonomik dhe financiar		Drejtoria për FEZH , Planifikim urban dhe mjedis	Pasi Plani zhvillimor i Komunës së Vitisë dhe Klllokotiti 2010-2020 + nuk e ka paraparë projektin e „Revitalizimi i ndërtesës së Komunës së Vitisë “por nevoja renovimit të këtij objekti komunal ishte shumë e madhe	Në fillim vitin 2022

	dhe të bëjnë vlerësimin e gatishmërisë së zbatimit të projektit.			sepse kushtet e punës ishin jo në nivel pune spese ndërtesa e ndërtuar para 70-80 viteve dhe e pa renovuar fare në këto dekada në kushte shume shumë të rënda për punë . Në fillim vitin 2022	
2	E gjetura 2 - Palët relevante të menaxhimit të Grantit të Performancës Komunale të rishikojnë mundësinë e vlerësimit/definimit më të hershëm të projekteve për financim, me qëllim të analizimit dhe vendosjes së projekteve me kohë krahas planifikimeve buxhetore dhe rrjedhimisht përfundimin e tyre sipas kërkesave të marrëveshjes;		Zyra për zhvillimi në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe zyrja e projekteve pranë zyrës së kryetarit	Pasi jemi në përfundim të „Planit zhvillimor komunal 2021-2030” dhe se do të prioritizohen shumë projekte të domosdoshme për të përfituar qytetarët e Komunës beso se në të ardhmen do të prioritizohen projektet të cilat kanë me u financuar nga granti i performancës e sidomos ato projekte që janë në shërbim direkt të qytetarit .	Në fillim vitin 2022
3	E gjetura 3 - Komunitat të fillojnë me iniciimin e realizimit të projekteve dhe procedurave të prokurimit në momentin e aprovimit të kërkesës nga njësia kërkuese dhe të evitohen pengesat e padobishme në procesin e prokurimit deri te nënshkrimi i kontratës, në mënyrë që të evitohet nënshkrimi i kontratave në pjesën e fundit të vitit;		zyrja e projekteve pranë zyrës së kryetarit dhe zyra e prokurimit pranë zyrës së kryetarit	Projekti i realizimit me grantin e performancës ishte projekt specifik kur ishte i mbushur me punëtorë të administratës komunale , ishte e planifikuar në kohë aktiviteti i prokurimit dhe është shpallur tenderi në muajin prill kohë optimale për realizimin e këtij projekti por mungesa e një objekti tjetër për ti transferuar punëtorët ka munguar dhe është dashur pjesë pjesë të punohet ( njëher kati i parë dhe së jashtëmi dhe faza e dytë - viti tjetër kati i dytë ) por do të kem kujdes në të ardhmen që sa më heret që është e	Në vitin 2021

				<b>mundur - në fillim të vitit të fillojmë me procedurat aktivitetit të prokurimit .</b>	
<b>4</b>	E gjetura 4 - Komunitat të sigurojnë kushte të përshtatshme për Operatorët Ekonomik që me rastin e nënshkrimit të kontratave të punës projektet të fillojnë dhe të realizohen pa pengesa;		<b>zyrja e projekteve pranë zyrës së kryetarit-zyrtari i caktuar si menagjer i projektit</b>	<b>Pas nënshkrimit të kontratës menjëher do të fillojmë me krijimin e kushteve për aq sa është e mundur që operatori ekonomik të fillojë me realizimin e projektit por kjo varet nga specifika e projektit dhe besoj si projekti i kaluar nuk do të kemi probleme në kryerjen e punëve krahas planit dinamik të realizimit të projektit . E gjetura</b>	Në vitin 2021
<b>5</b>	E gjetura 5 - Menaxherët e projekteve të sigurohen që OE-të përmbushin të gjitha detyrimet kontraktuale dhe në rastet kur të njëjtit nuk i përgjigjen obligimeve të rekomandohen masat juridike të parapara në kontratë.		<b>Zyrja e projekteve pranë zyrës së kryetarit-zyrtari i caktuar si menagjer i projektit</b>	<b>Menagjeri i zgjedhur i projektit duhet të zbatohet dhe do të zbatohet detyrat e realizimit të projektit konform planit të projektit që operatori ekonomik të përmbush obligimet e veta kontraktuale në kohën e paraparë me planin dinamik të realizimit të projektit .</b>	Në vitin 2021